

Bismilahi Rrahmani Rrahim!

Në emër të Zotit, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

I nderuar President i Republikës, Shkëlqesia Juaj, Meta!

Të nderuar autoritete të larta të Ministrisë së Jashtme Të **Hollandës**!

Të nderuar vëllezërit e mi, **liderë** të feve në Shqipëri!

E prita me kënaqësi ftesën e organizatorëve të konferencës rajonale “Roli i fesë në shoqëritë e Ballkanit Perëndimor” dhe kam rastin që në cilësinë e Kryegjyshit Botëror Bektashian, t’ju uroj së pari fat dhe mbarësi në familjet tuaja! Gjithashtu, i uroj punime të mbara kësaj konference! Në të vërtetë, sfidat me të cilat përballlet sot Ballkani Perëndimor janë të mprehta dhe shumëdimensionale. Në këtë kontekst, rolin të fesë dhe kontributit identitar të saj, vlen t’i jepet vendi i merituar. Sidomos për shkak të historisë nga erdhën popujt e Ballkanit në këto treva, por edhe të shtetëzimeve etnike gjuhësore dhe kulturore, një mori traditash dhanë e morën me njëra-tjetrën në shekuj, duke u zgjeruar dhe pasuruar me elemente të rinj dhe duke ndërtuar një mozaik tejet të larmishëm fetar. Nëse do të para-përfytyrojmë për një çast edhe impenjimin e vazhdueshëm të Perandorisë Osmane për këtë rajon, atëherë do të kuptojmë më së miri komunikimin dhe bashkëpunimin natyral të identiteteve etno-kombëtare me identitetet universaliste të Islamit dhe feve të tjera.

Në mënyrë të veçantë në shekullin e njëzetë, për shkak të sagës së dhimbshme të mërive Ballkanike, por edhe interesave që ushqenin Fuqitë e Mëdha, ka një konturim të ri fetar, brenda mjedisit politiko-kulturor të Evropës Juglindore. Këtu nuk është vendi dhe koha për arsyetime të mëtejshme në këtë kontekst, por modelimi i natyrshëm ndaj perceptimeve dhe terreneve të rinj fetarë, vazhdon qysh prej asaj kohe deri më sot.

Pikërisht, në këtë këndvështrim, debatet dhe idetë në këtë konferencë mund të jenë mjaft frutdhënëse. E rëndësishme për mendimin tim është që ne të kthejmë kokën prapa jo për të ndezur gjakrat, por për të kërkuar mjete shëruese që gjenden aty shumë në resurset tona shpirtërore. Jemi bij të një zoti të vetëm dhe dashuria midis njeri-tjetrit, padyshim, është vullneti i Tij!

Të nderuar të pranishëm!

Tarikati të cilit i përkas, ai Bektashian, në këta shtatë shekuj të ekzistencës së tij në Ballkan, si një degë e shëndoshë në trupin madhështor të Islamit, ka dëshmuar një nga parimet më esenciale të filozofisë së doktrinës së tij, pikërisht kulturën e thellë të bashkë-ekzistencës fetare. Teqetë Bektashiane, nga Nishi i Jugosllavisë, në Bosnje, Rumani, Bullgari, Kosovë, Maqedoni të Veriut e deri në Kretë të Greqisë, përgjatë shekujve, janë shndërruar në vatra të përhapjes së besimit në Zot, në oaze paqeje dhe shprese për çdo besimtar, për çdo udhëtar të zakonshëm, pavarësisht përkatësisë së tij racore, etnike apo fetare. E parashikuar dhe identifikuar në çdo nen të kodit tonë zakonor, mikpritja, qysh në krye të herës, ka bërë që teqetë të shiheshin jo vetëm si objekte të tarikatit Bektashian, por edhe si streha të lëvizjeve popullore për reforma moderniste.

Në mënyrë të veçantë, pas shpërnguljes me dhunë nga Turqia dhe vendosjes në Shqipëri në vitin 1930, Kryegjyshata Botërore, u kujdes të luante rolin e saj historik jo thjeshtë në trajtat vijuese të tarikatit, por edhe në kontekstin e ndërveprimeve fetare në këtë treve. Sidoqoftë,

pavarësisht arritjeve, ne jemi të ndërgjegjshëm se me vullnetin e Zotit përpara, kemi shumë për të bërë.

Ne gjykojmë se është shumë e nevojshme të njohim përveç librave të shenjtë edhe filozofinë, doktrinat dhe praktikën e fesë njeri-tjetrit, sikundër vlen të respektojmë në thellësi traditat. Në respekt të traditave etno-kulturore, ne liderët fetarë në Ballkan, mendojmë se mund të bashkohemi më fortë se deri tani, në frontin kundër politizimit të fesë apo ekstremizmave që na vijnë jashtë këtyre trevave. Ne duhet të jemi syçelët në vëllazërinë fetare që duam të promovojmë.

Zoti ju bekoftë të gjithëve!

Amin!

Fjala e Kryegjyshit Botëror Bektashian,

Hirësia e Tij,

Haxhi Dede Edmond Brahimaj

Presidencë – Tiranë, 11 Qershor 2019